



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2025:028994

Datë: 26.03.2025

Numri i dokumentit: 07049146

AA.nr.266/2025

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit-propozuesit, Xh.M, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Rreze Shkodra, avokate nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave për të Huajt, me seli në Prishtinë, të cilën sipas ligjit e përfaqëson, Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, nën shenjën A.nr.501/2025, të datës 25.02.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.03.2025, merr këtë,

**A K T V E N D I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit-propozuesit, Xh.M, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.501/2025, i datës 25.02.2025, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.501/2025, të datës 25.02.2025, është vendosur, *“I. REFUZOHET SI E PA BAZUAR kërkesa e paditësit Xh.M, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate Rreze Shkodra nga Prishtina, Rr.”Luan Haradinaj” nr.17/7, me të cilën ka kërkuar që të “miratohet në tërësi si i bazuar propozimi-kërkesa e propozuesit Xh.M, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me nr.05/2015 të datës 16.01.2025 dhe të shtyhet ekzekutimi i vendimit me nr.05/2015 të datës 16.01.2025, deri në vendosjen e këtij kontesti me vendim përfundimtarë gjyqësor sipas padisë së parashtruar”.* II. Procedura në këtë konflikt administrativ do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës në konfliktin administrativ dhe sipas planit të punës të gjykatës.”

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësjë, përmes ta autorizuarit të saj, Rreze Shkodra, avokate nga Prishtina, për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës, shkeljes së ligjit material, dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit, të anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.501/2025, i datës 25.02.2025, dhe të shtyhet ekzekutimi i vendimit

nr.05/2025 të datës 16.01.2025, i të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave për të Huajt, deri në vendosjen meritore sipas padisë së paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala e paditur.

Kolegji i apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 90 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 194, 195, 200, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vëren se ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 14.02.2025, ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, për anulimin e vendimit të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave për të Huajt, me seli në Prishtinë, me propozim për shtyrjen ekzekutimit të tij nga arsyet e dhëna në padi dhe propozim.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit, e duke u bazuar edhe në provat dhe dokumentet e bashkangjitura në padi, kërkesën e paditësit e refuzon si të pa bazuar me arsyetim se *“Për të vlerësuar kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar nr.05/2015 të datës 16.01.2025 të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave për të Huajt, gjykata si fillim i’u referua nenit 99 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative nr.08/L-182 ku përcaktohet “1.Për sigurimin e padisë në rastin e padive për anulimin e një akti administrativ sipas nenit 14 të këtij Ligji apo një padie për ndalimin e kryerjes të një veprimi tjetër administrativ sipas nën paragrafit 1.1 të nenit 16 të këtij Ligji, Gjykata, me kërkesë, mund të vendosë pezullimin e zbatimit të aktit apo përkatësisht ndalimin e menjëhershëm të veprimit tjetër administrativ. Po ashtu gjykata i’u referuar edhe nenit 100 par.1 të ligjit të njëjtë ku është paraparë se “1. Masa e sigurisë e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2, të nenit 99 të këtij Ligji, mund të vendoset nëse nga një shqyrtim paraprak, Gjykata, vlerëson se plotësohen këto kushte: 1.1.marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshem ndaj interesave të propozuesit të masës; 1.2.marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik”. Gjykata vëren se sipas dispozitave relevante të cekura më lartë, për shtyrjen e ekzekutimit të një akti administrativ, është e nevojshme të plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte: i) marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshem ndaj interesave të propozuesit të masës dhe ii) marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik. Bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lart, gjykata në respektim të parimit të proporcionalitetit, lidhur me kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të atakuar me padi, shqyrtoj plotësimin e kushteve nga nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të nenit 100 Ligjit për Konfliktet Administrative nr.08/L-182, dhe gjeti se kërkesa e paditësit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, në rrethanat e tanishme nuk është e bazuar. Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se paditësi në kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, nuk ka paraqitur prova bindëse bashkëlidhur kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit se përse marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshem ndaj interesave të paditësit dhe se pse marrja e masës së sigurisë në këtë rast nuk cenon rëndë interesin publik. Gjykata thekson se paditësi në kërkesën për shtyrjen e ekzekutimi të vendimit të kontestuar ka pretenduar në rast të mos aprovimit të shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, për shkak të rrethanave të krijuara propozuesi do të jetë i rrezikuar nga rrethanat të cilat do të krijohen nëse gjendet jashtë Republikës së Kosovës, dhe se ekzekutimi i vendimit kontestues i të paditurës, pa shmangshëm do mund ti sillte dëm të rëndë dhe të pa kthyeshem paditësit, duke i’u rrezikuar edhe jetën nëse gjendet jashtë Republikës së Kosovës e në territorin e Republikës së Serbisë, sepse në momentin e legjitimitetit të tij do të identifikohet përkatësi e tij dhe do të arrestohet, mirëpo nuk ka qenë në gjendje të argumentoj këto pretendime me prova dhe dëshmi konkrete. Gjykata vlerëson se edhe pretendimi tjetër i deklaruar i paditëses se marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik nëse propozuesi do të qëndronte në territorin e Republikës së*

*Kosovës, deri në vendosjen lidhur me fitimin e shtetësisë si pjesëtar i diasporës meqë propozuesi është duke kompletuar dokumentacionin e nevojshëm, sikurse pretendimi se i njëjti ka ndalesë për kthim në shtetin Gjerman ku ka lindur për 7 vite, janë pretendime të karakterit deklarativ, të pa provuar dhe në nivel hipotetik, pasi nuk janë paraqitur prova në mbështetje të tyre, ku do të provohej se marrja e masës të sigurisë në këtë rast është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshem ndaj interesave të propozuesit të masës dhe se marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik, ashtu siç parashihet me nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të nenit 100 Ligjit për Konfliktet Administrative nr.08/L-182. Gjykata nënvizon se mosdakordësia me vendimin e kontestuar të paditurës, nuk përbën në vet vete, shkak për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Së këndejmi, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi me asnjë provë konkrete nuk ka arritur të argumentoj se në rastin konkret plotësohen në mënyrë kumulative dy kushtet e parapara me nenin 100 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative nr.08/L-182, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar me padi. Gjykata thekson se në rastin konkret ndaj paditësit ka filluar vetëm procedura për largim vullnetar nga organi i paditur, bazuar në dispozitat e nenit 94 dhe 96 të Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt dhe nenin 31 par.1 dhe 2 të Ligjit nr.06/L-036, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt, dhe se në rast të marrjes së masave tjera nga e paditura për largimin me forcë të paditësit sipas neneve 97 dhe 98 të Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt, atëherë paditësi do të mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore, duke përfshirë edhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë. Gjykata vë në dukje se vendosja lidhur me kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, nuk ka të bëjë me vendosjen përfundimtare të këtij konflikti administrativ sa i përket ligjshmërisë së aktit administrativ të kontestuar dhe se në këtë rast nuk është bërë vlerësimi i fakteve në atë mënyrë që në ndonjë mënyrë mund të aludonte në mënyrën e vendosjes përfundimtare, porse në këtë fazë gjykata mbështet në kushtet e përcaktuara nga nenit 100 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative nr.08/L-182, që ka të bëjë me atë se; marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshem ndaj interesave të propozuesit të masës; marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik.”*

Kolegji i Gjykatës së Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të përcaktuara me nenin 100 paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një përfundim të tillë të Gjykatës së shkallës së parë.

Me nenin 100 të Ligjit Nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative është përcaktuar se “1. Masa e sigurisë e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2, të nenit 99 të këtij Ligji, mund të vendoset nëse nga një shqyrtim paraprak, Gjykata, vlerëson se plotësohen këto kushte: 1.1.marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshem ndaj interesave të propozuesit të masës; 1.2.marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik.”

Kjo dispozitë në mënyrë qartë përcakton se për caktimin e masë së sigurisë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushtet e përcaktuara “1.1 marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshem ndaj interesave të propozuesit të masës; 1.2.marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik.”

Në rastin konkret paditësi me ankesën e ushtruar kërkon shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me arsyetim se, *“Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar faktet të cilat janë të shumta lidhur me këtë çështje e të cilat do të ndikojnë direkt në shkaktimin e dëmit të pariparueshëm të paditësit-propozuesit e duke i sjellur dëme edhe vështirësi, duke përfshirë edhe sigurinë e tij personale sepse i njëjti nëse largohet nga territori i Republikës së Kosovës dhe dërgohet në pikën kufitare në Merdar, gjasat për tu arrestuar nga organet policore të Republikës së Serbisë do të ishin evidente, siç ka ndodhur edhe me raste tjera të shtetasit të republikës së Kosovë janë gjendur në territorin e tyre...”* Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të paditësit në ankesë të cekura më lartë ndaj aktvendimit të Gjykatës së shkallës së parë, kolegji i apelit vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara me prova konkrete për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit.

Po ashtu kolegji vëren se paditësi përtej përshkrimit të dispozitave relevante ligjore nga neni 99 dhe 100 të KLA-së, ai është i detyruar duhet të provoj me prova konkrete, argumentet në mbështetje të plotësisht të kriterëve ligjore për caktimin e masës së sigurisë, përkatësisht të provonte me prova se cili është ai dëm që i shkaktohet paditësit, dhe pse ai dëm është i pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës, dhe se marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik, kushte këto ligjore për caktimin e masës së sigurisë, të cilat duhet të provohen nga paditësi. Në këtë drejtim paditësi-propozuesi nuk ka argumentuar me ndonjë provë të besueshme në propozimin e tij se në këtë fazë të procedurës caktimi masës së sigurisë kundër vendimit të kontestuar është e domosdoshme për të shmangur ndonjë dëm të rend dhe të pakthyeshëm dhe se caktimi i masës së sigurisë nuk do të cenonte interesin publik.

Kolegji vlerëson se vetëm pretendimi i propozuesit se do të shkaktohet dëm, e vlerësoi si argument të pamjaftueshëm për caktimin e masës së sigurisë kundër të vendimit të kontestuar, sepse sipas vlerësimit të kolegjit dëmi duhet të jete real, përkatësisht i pakthyeshëm dhe se i njëjti duhet të provohet me prova konkrete. Kjo për faktin se propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kryesisht është e mbështetur në fakte dhe prova që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, përkatësisht objektin e kërkesëpadisë së paditësit, për të cilat Gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të padisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Prandaj, nëse gjykata në rastin e vendosjes sipas padisë së paditësit, gjen se vendimi e të paditurit është i paligjshëm, atëherë çfarëdo dëmi eventual i shkaktohet ndaj paditësit mund të llogaritet dhe mund të kompensohet.

Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve kolegji i apelit vëren se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Në këtë kuptim, bazuar në arsyet e dhëna më lart, kolegji i apelit vlerëson se aktvendimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktvendimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktvendimit, dhe se aktvendimi përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe kolegji i apelit, dhe nga këto arsye ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i goditur me ankesë vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Numri i lëndës: 2025:028994  
Datë: 26.03.2025  
Numri i dokumentit: 07049146

Nga arsyet e dhëna më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 208 dhe nenin 209 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenet 90 paragrafi 1.2 dhe 95 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
AA.nr.266/2025, datë 26.03.2025

Kryetari i kolegjit  
Hajriz Hoti